



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 874/24 Datë: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Akademia Tempulli në Prishtinë në nivel institucional, për periudhën tre (3) vjeçare 1 tetor 2024 - 30 shtator 2027.
- II. Obligohet Akademia Tempulli që deri më datë 15.11 2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij,

A R S Y E T I M

Akademia Tempulli ka parashtruar kërkesë me Nr.prot. 1511/23, datë 31.10.2023, në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Akademinë Tempulli me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 09.02.2024, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Milan Pol, Magdalena Platis, Lali Giorgitze.

Bazuar në nenin 17 të UA. Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Akademia Tempulli është vlerësuar se përmbushë: Plotësisht një (1) Substancialisht tetë (8) dhe Pjesërisht dy (2) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 122-të, të mbajtur më datë 22.04.2024 ka shqyrtuar kërkesën/aplikacionin e Akademisë Tempulli dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur me sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Akademisë Tempulli;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shkencor të AKA-së

